

PARTNERITETI SOCIAL NE NIVELIN E BAZES  
MUNDESON ZGJERIMIN E PUNES ME KONTRATA  
KOLEKTIVE

( Pergatitur nga **KIÇO ZISO**, Bashkepunetor Shkencor  
ne Institutin e Punes BSPH )

Partneriteti Social me perfaqesimet e tij dy apo tre paleshe zhvillohet ne disa nivele (Tabela 1).

Niveli i pare: i marredhenieve te partneritetit social eshte ai i marreveshjeve ne shkalle kombetare te arritura midis Konfederatave Sindikale me Qeveine, i Konfederatave te Biznesit me Qeveine ose ato tri-paleshe midis tyre.

Niveli i dyte: jane Marreveshjet Kolektive te Degeve ose siç quhen ndryshe kontratat kolektive te nivelit te pare, te cilat realizohen midis Federatave Sindikale dhe Ministrive te Linjes ose dhe nga organizatat perkatese te Punedhenesve kur ka te tilla.

Niveli i trete: jane marredheniet tripaleshe vendore ose te Qarqeve qe zhvillohen midis Sindikatave te bazes, organizatave apo shoqatave punedhenese dhe zyrave te Punes ne Qark.

Dhe Niveli i katert: i marredhenieve te partneritetit jane ato te kontratave kolektive te Punes qe realizohen ne menyre dypaleshe midis Sindikates dhe drejtuesve te Ndermarjes ose biznesit.

Keto nivele te zhvillimit te marredhenieve te partneritetit social jane te lidhura midis tyre dhe ndikojne me njera – tjetren.Por secili prej tyre ka rolin dhe rendesine e vet ne ecjen perpara te problemeve sociale te vendit.

- Nga analiza 10 vjeçare e zhvillimit qe prej themelimit institucional te ketyre niveleve te partneritetit social ne vendin tone, rezulton si me i suksesshem zhvillimi i marredhenieve te partneritetit ne nivelin e degeve, ose siç quhen ndryshe kontratat e nivelit te pare.Kjo shprehet me se miri ne faktin se tashme pothuajse te gjitha federatat e dy sindikatave me te medha te vendit BSPSH dhe KSSH prej vitesh kane krijuar traditen e lidhjes se marreveshjeve kolektive te punes me dikasteret perkatese dhe me Organizatat dhe Shoqatat e punedhenesve aty ku ato funksionojne.Kjo shprehet ne faktin e zgjerimit te numrit te ketyre marreveshjeve gjate periudhes 10 vjeçare qe prej vitit 1996 kur edhe ka filluar ndjekja institucionale e tyre nga ana e Ministrise se Punes.Keshtu ne baze te te dhenave te kesaj Ministrie, nga 10 marreveshje te lidhura gjate periudhes 1996-2000, numri i tyre arriti mbi 20 per periudhn 2001-2005.
- Jemi te ndergjegjshem se te tilla marreveshje te nivelit te pare te lidhura ne disa raste edhe ne menyre te perbashket mes dy konfederatave tona me dikasteret e punedhenesit, jane nje mbeshtetje me vlere te medha metodologjike e juridike, qe e lehtesojne shume procesin e lidhjes se kontratave kolektive ne baze ose siç i quajne ndryshe kontratat te nivelit te dyte.
- Çeshtja e mbarevajtjes se marreveshjeve te bazes ne ndermarrje ka rendesi edhe me te madhe ne kuadrin e marredhenieve te partneritetit social te vendit sepse ne kontratat e punes ne ndermarrje e sidomos ne ato kolektive, reflektohen ne menyre te sintetizuar i tere kuadri i mbrojtjes juridike qe perfshihen ne Konventat Nderkombetare dhe nga legjislacioni yne i punes.Prandaj lidhja dhe zhvillimi sa me i gjere e i plote i ketyre kontratave ne baze perben thelbin e punes se sindikatave, devizen e tyre ose siç quhen ndryshe kryefjala e sindikalizmit.
- Duke qene se kjo çeshtje perben dhe fokusin e kesaj kumtese, ne vijim analizohet me gjeresisht shkalla e shtrirjes se punes me kontrata kolektive ne nivelin e bazes ne ndermarrje dhe biznese.Proçesi i lidhjes se kontratave kolektive te nivelit te dyte pra ne ndermarrje, ne rruge shteterore ndiqet vetem nga ana e

Sherbimit Kombetar te Punesimit.Nga analiza 10 vjeçare e te dhenave statistikore te ketij institucioni rrezulton se lidhja e kontratave te punes ne ndermarjet publike dhe ato private ka pershkuar nje rruge plot zig-zage neper vite, me ulje e ngritje qe jane pasqyre e luhatjeve te zhvillimit te reformes ekonomike dhe te krizave qe i ka kaluar vendi.Keshtu niveli prej 31% i te punesuarve me kontrata pune qe eshte arritur ne vitin 1996 apo ne 22% ne vitin 2000 e u ngrit ne 31% ne vitin 2002 dhe 37% ne vitin 2005, siç duket nga te dhenat e meposhtme:

Nr	Treguesit	Njesia matese	Vitet			
			1996	1999	2002	2005
1	Punonjes gjithsej	000/vete	419	395	393	234
	Me kontrata	000/vete	129	99	120	87
	Ne %		31	25	31	37
2	Sekt. Shteteror	000/vete	207	188	185	134
	Me kontr.	000/vete	82	61	77	57
	Ne %		40	33	42	43
3	Sekt privt. jo bujqs.	000/vete	212	207	208	100
	Me kontr.	000/vete	47	37	43	29
	Ne %		22	18	21	29

Nga analiza e ketyre te dhenave rrezulton se ne sektorin shteteror mbulimi i te punesuarve me kontrata kolektive paraqitet ne nivelin nga 40% ne 43%, kurse ne sektorin privat nga 22-29%.Kjo ka sjelle qe mbulimi i te punesuarve me kontrata ne teresine e sektorit shteteror e ate privat jo bujqesor te rritet nga 31% ne vitin 1996 ne 37% ne vitin 2005.Kjo verteton se niveli i punes me kontrata kolektive te nivelit te dyte ka nje prapambetje ne kahasim me ecurine me te mire qe verehet ne marreveshjet kolektive te nivelit te pare.

Prapambetja e zgjerimit te punes me kontrata kolektive te nivelit te dyte ka disa shkaqe:

- Se pari presioni me i ulet nga ana e drejtimit sindikal ndaj bazes ne krahasim me mbarevajtjen e kontratave kolektive te nivelit te pare.
- Se dyti mos funksionimi i plote i marredhenieve tte partneritetit social ne nivel qarku.
- Se treti zbehja e interesimit nga ana e shtetit per pasqyrimin e sakte dhe ndjekjes statistikore te ketij treguesi.Kjo shprehet ne faktin se ndersa ecuria e kontratave kolektive te punes ne baze ne shifra relative ka nje fare rritjeje ne vitin 2005 ne krahasim me vitin 2002 (nga 30% ne 37%), ne shifra absolute, si te punesuarit edhe ata me kontrata pune jane te dyja te zvogeluara afro 40% me pak ne vitin 2005 kundrejt vitit 2002.Kjo ka ndodhur sepse ne vitin 2004 nga ana e Qeverise me nje Vendim nr.771 eshte hequr detyrimi i bizneseve per siglimin e raportimit te shifrave te punesimitdhe mbulimit me kontrata ne zyrat e punes duke raportuar te tilla te dhena kush deshiron vetem nen zyrat e tatimeve.Ky shkurtim i ciklit te vjeljes se detyrimeve tatimore u be ne kurriz te statistikave te tregut te punes, te cilat aktualisht jane statistikat me te dobeta dhe me plot pengesa dhe te pa-rakorduara.
- Prapambetja e nivelit te kontratave te punes ne vendin tone verehet edhe ne faktin se jemi ende shume mbrapa ne krahasim me disa shtete te Evropes Perendimore (Tabela 4).Kjo duket edhe nga te dhenat e meposhtme te shprehura ne %:

1. Shqiperia	37%
2. Britania	47%
3. Portugalia	71%
4. Spanja	78%
5. Hollanda	81%
6. Italia	83%
7. Danimarka	86%
8. Suedia	89%
9. Belgjika	90%
10.Gjermania	92%
11.Franca	95%
12.Finlanda	96%
13.Austria	98% etj...

- Nje aspekt tjetër i prapambetjes se zgjerimit te punes me kontrata ne nivelin e bazes shprehet edhe ne shifrat me te ulta te kontraktimeve qe

rrezultojne ne Qarkun e Tiranës krahasuar me qarqet e tjera te vendit, ku Tirana renditet e fundit me nivelet nga 10% ne 15%, rritje relative nga krahasimi i vitete 2002 dhe 2005 (Tabela 5), siç duket edhe nga te dhenat e meposhtme:

*Dinamika e mbulimit te punes me kontrata sipas Qarqeve per vitet 2002-2005:*

Nr	Qarqet	Viti 2002			Viti 2005		
		Te punesuar gjithsej	Me kontr. Pune	Ne %	Te punesuar gjithsej	Me kontr. Pune	Ne %
1	Berat	14680	3356	23	8367	2983	36
2	Diber	11539	8774	76	4029	1397	35
3	Durres	29466	14007	47	1083	5779	53
4	Elbasan	26416	6275	24	25475	4405	17
5	Fier	30102	22776	74	28352	13106	46
6	Gjirokaster	11192	2707	24	11498	7642	66
7	Korce	24043	14728	61	12662	7682	61
8	Kukes	8246	5166	63	4198	4198	100
9	Lezhe	12720	3793	30	12297	2964	24
10	Shkoder	19984	9796	49	19576	13182	67
11	Tirane	183303	17610	10	80962	12421	15.3
12	Vlore	21207	13606	64	16143	11105	68
	Gjithsej vendi	392898	120450	30.6	234393	86764	37

Çeshtja e prapambetjes se theksuar te nivelit te punes me kontrata per Qarkun e Tiranës meriton vemendje te posaçme per nga pesha e madhe qe ka ne numrin e te punesuarve e cila eshte rreth 173 mije vete pa bujqesine ose mbi 40% te punesimit ne sektorin shteteror dhe ate privat jo bujqesor te vendit. Gjithashtu kjo gjendje duhet vleresuar nga te gjithe per te siguruar daljen nga prapambetja edhe per faktin se ketu jane te perqendruara forca te medha sindikaliste te vendit. Ky proces zgjerimi i punes me kontrata kolektive per Qarkun Tirane duhet filluar nga perqendrimi i forcave sindikale jo ne te gjithe te punesuarit, por kryesisht

ne ndermarrje e biznesit te vogel, te mesem e te madh, duke perjashtuar keshtu mikrobizneset me perberje 1-5 veta te punesuar.

- Perqendrimi i punes sindikale ne keto lloj biznesesh relativisht te medha eshte karakteristike edhe ne shkalle vendi (Tabela 6). Sipas te dhenave te INSTAT\_it 2003 bizneset e vogla, te mesme e te medha perfaqesohen nga 3185 biznese ose 6% te numrit te bizneseve te vendit. Por ata perfaqsojne 142 mije te punesuar dhe kjo perben nje shifer te madhe pune per mbulimin e tyre me kontrata kolektive ne nje kohe qe nese BSPSH nuk mbulojne me shume se 250 biznese me kontrata kolektive ne shkalle vendi, ndersa ne shkalle Tirane mbulojne 110 biznese nga 1250 biznese te vogla, te mesme e te medha qe jane ne Tirane. Kjo perben nje shifer shume te vogel as 10% te mbulimit te numrit te ketyre bizneseve, ç'ka tregon se ne kete drejtim kemi shume per te bere. Kjo kerkon nje bashkerendim me te mire te puneve midis sindikatave dhe zyrave te punes ne qark se bashku me ato te Organizatave dhe Shoqatave te biznesit. Per kete duhet te fiksohet dhe te funksionojë zyra e marrredhënieve te partneritetit per Qarkun e Tiranës, ku te analizohen here pas here ne nivel tri palesh problemet e mbarevajtjes se tregut te punes dhe zgjerimi i punes me kontrata kolektive, rakordimi i shifrave dhe sidomos ana cilesore e zbatimit te ketyre kontratave duke evidentuar rastet e shkeljeve te te drejtave te punetoreve dhe te raportohet zgjidhja e tyre.
- Nje ndihmese te madhe ne zgjidhjen e shpejte te konflikteve ne lidhje me zbatimin e kerkesave te kontratave kolektive te punes do te jepte ngritja dhe funksionimi sa me pare i Gjykatave te Punes per te cilen edhe pse eshte folur shume ende nuk po veprohet.
- Edhe marrja ne analize e problemit te zgjerimit te punes me kontrata kolektive nga ana e Sherbimit Kombetar te Punesimit do te ishte nje moment tjetër qe do te jepte shtyssen e vet ne ecjen perpara te nivelit te punes me kontrata.


### **PERFUNDIME DHE REKOMANDIME:**

Konstatojme:	Rekomandojme:
Verehet prapambetje e kontraktiveve te nivelit te dyte	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te funksionojë partneriteti 3 palesh ne nivel qarku</li> <li>• Te fiksohen zyrat</li> </ul>

Ka pasaktesi statistikore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te konfirmohen shifrat e nivelit te punesimit dhe kontratave ne qark me 3 firma</li> <li>• Te rakordohen shifrat e SHKP-se me ato te INSTAT-it.</li> </ul>
Tirana eshte me ulet ne nivelin e kontraktimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te funksionoje zyra e partneritetit ne Qarkun e Tiranes</li> <li>• Te perqendrohemi ne biznesin e vogel, te mesem e te madh</li> <li>• Sindikatat te lidhen me zyrat e punes per shifrat e kontraktime.</li> </ul>
Kujdes cilesise se zbatimit te kontratave te punes	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te evidentohen rastet e shkeljeve dhe te raportohet zgjidhja e tyre</li> <li>• Te ngrihen dhe te funksionojne Gjykatat e Punes</li> <li>• Te merret ne analize zgjerimi i punes me kontrata ne K.K Punes</li> </ul>

**TABELA 1**

## **NIVELET E ZHILLIMIT TE PARTNERITETIT SOCIAL**




***Tabela 2***

**PARAQITJA E NUMRIT TE PUNONJESVE ME KONTRATA PUNE NE SEKTORIN SHETETEROR DHE NE ATE PRIVAT JO BUJQESOR NE 7 VITET (1996-2002)**

	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	ne 000/vet
sekt.privat jo bujqesor	212.4	203.4	213.3	207.2	214.8	205.3	207.7	
nga keta me kontrate pune	47.2	32.5	39.5	37.4	40	42.1	43.1	
ne %	22.2	16	18.5	18	18.6	20	20.7	
nga keta me kontrate	129.3	89.3	94.2	99	89	90.3	120.4	
ne %	30.8	22.2	22.8	25	21.7	23	30.6	
Sektori Shteteror	206.6	199.3	200.6	187.6	195.8	186.8	185.2	
nga keta me kontrate	82.1	56.8	54.7	61.6	49	48.2	77.3	
ne %	39.7	28.5	27.3	32.8	25	25.8	41.7	

Grafiku i shprehur ne perqindje




**Tabela 3**


**PUNONJESIT ME KONTRATA PUNE NE TRE VITET E FUNDIT (2002-2005)**

(ne mije/vete)

Treguesit	Ne vitin 2002	Ne vitin 2003	Ne vitin 2005
Gjithsej punonjes	393	397	234.4
nga keta me kontrate	120.4	129.7	86.8
Gjithsej ne %	30.6	32.7	37
sekt. Shteteror	185.2	189.5	134.4
nga keta me kontrate	77.3	58.4	57.4
Shteteror ne %	41.7	30.8	42.7
sekt.privat jo bujqesor	207.7	207.5	100
nga keta me kontrate	43.1	71.3	29.4



**PERQINDJA E PUNONJESVE QE PUNOJNE ME KONTRATA PUNE NE VENDET E EUROPES**  
**PERENDIMORE**




**Tabela 4**

**Tabela 5**

**TE PUNESUARIT ME KONTRATA PUNE SIPAS QARQEVE NE VITET 2002 DHE 2005**


Nr	Qarqet	Viti 2002			Viti 2005		
		punetore gjithsej	me kontrate	ne %	punetore gjithsej	me kontrate	ne %
1	Berat	14680	3356	23	8367	2983	36
2	Diber	11539	8774	76	4029	1397	35
3	Durres	29466	14007	47	10834	5779	53
4	Elbasan	26416	6275	24	25475	4405	17
5	Fier	30102	22776	74	28352	13106	46
6	Gjirokaster	11192	2707	24	11498	7642	66
7	Korce	24043	14728	61	12662	7682	61
8	Kukes	8246	5166	63	4198	4198	100
9	Lezhe	12720	3793	30	12297	2964	24
10	Shkoder	19984	9796	49	19576	13182	67
11	Tirane	18303	17610	10	80962	12421	15.3
12	Vlore	21207	13606	64	16143	11105	68
	Vendi	392898	120450	30.6	234393	86764	37

Paraqitja grafike ne %



**Tabela 6**

**Punesimi sipas madhesise se ndermarrjeve ne vitin 2003**



Viti 2003